ANALIZA E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË STAFIT AKADEMIK NGA KONKURSI NR. 804 – 2021 NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

Publikues:

ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Henrik Bariç, Nr. 6

Prishtina, 10000, Kosova

Autor:

Adea Kondirolli

Prishtinë, shkurt 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 3
Rezultatet e përgjithshme 4
Rezultatet sipas titujve akademikë 4
Profesor asistent 4
Profesor i asocuar 5
Profesor i rregullt 5
Rezultatet sipas fakulteteve 6
Fakulteti i Arkitekturës 6
Fakulteti i Ndërtimtarisë 6
Fakulteti Juridik 6
Fakulteti i Arteve 6
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 7
Fakulteti i Filologjisë 7
Fakulteti Ekonomik 7
Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore 7
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit 8
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë 8
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 8
Fakulteti Filozofik 9
Fakulteti i Edukimit 9
Fakulteti i Mjekësisë 9
Rezultatet sipas gjinisë 10
Metodologjia 11
Baza ligjore 11
Objekti i shqyrtimit 11
Plotësimi i kritereve për avancim 12

HYRJE

Konkursi nr. 804 të datës 14 maj 2021, shënon një nga konkurset më të suksesshme të monitoruara nga ORCA në 5 vitet e fundit në Universitetin e Prishtinës.

Me rregulloren e re nr. 191 për emërime, riemërime dhe avancime akademike, janë ngritur kriteret për përzgjedhje të stafit akademik, në një nivel të kënaqshëm, por që ka ende vend për përmirësim.

ORCA përgjatë proceseve të avancimeve akademike shqyrton vetëm plotësimin e kriterit të publikimeve shkencore të kërkuara nga Statuti, Udhëzimet Administrative 01 dhe 07/2018, si dhe rregullorja nr. 191. Për këtë arsye, shqyrtohen vetëm pozitat për mësimdhënës (për titujt profesor asistent, i asocuar, dhe i rregullt), në aspektin e plotësimit të kriterit të publikimeve shkencore.

Nga 131 profesorë të shqyrtuar dhe të emëruar, riemëruar, ose avancuar, 130 janë avancuar me meritë, sa i përket publikimeve shkencore. Një kandidat ORCA ka vlerësuar që nuk i plotëson kriteret sa i përket publikimit shkencor, për shkak të një punimi në të cilin ai nuk figuronte si autor korrespondent në momentin e verifikimit. Korrespondenca është ndryshuar më vonë.

Një rast tjetër është një kandidat në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, i cili ka shërbyer si kryetar i Këshillit Drejtues deri pasi është shpallur konkursi nga universiteti. I njëjti është propozuar për emërim në profesor asistent (pozitë për të cilën ai plotëson kriterin e publikimeve shkencore). Ky emërim është bërë kundërligjshëm, duke u shkelur Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili nuk lejon emërimin e personave që kanë pasur pozita të larta mbikëqyrëse "të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik".

Në këtë konkurs janë riemëruar 14 persona në titujt që i posedonin tashmë. Në disa raste kjo është bërë për shkak të mungesës së publikimeve shkencore, në përputhje me gjetjet e ORCA-s, por në raste të tjera, Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati i Universitetit të Prishtinës kanë zbatuar edhe kriteret tjera po aq të rëndësishme, që kërkojnë që profesorët të kenë certifikata mësimdhënieje, monografi, tekste mësimore, pjesëmarrje në projekte, në konferenca, mentorime të kandidatëve për master dhe PhD, etj.

Pavarësisht tentativave për avancime akademike jomeritore përgjatë këtij konkursi, ORCA është e kënaqur që menaxhmenti dhe Senati i tanishëm i Universitetit të Prishtinës ka mirëmbajtur standardet e vendosura, dhe ka vendosur standarde të reja, që çojnë në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, dhe rrjedhimisht të arsimit.

ORCA rekomandon që të specifikohen më mirë disa nga çështjet e ngritura gjatë këtij konkursi, si autorësia, korrespondenca, etj., dhe të ndërmerren masa ndaj profesorëve dhe komisioneve vlerësuese që nuk kryejnë detyrat e tyre me integritet dhe etikë të lartë.

REZULTATET E PËRGJITHSHME

Në konkursin nr. 804 të datës 14 maj 2021, janë shpallur pozita në 14 fakultetet e Universitetit të Prishtinës për mësimdhënës dhe asistentë. ORCA ka shqyrtuar vetëm pozitat për mësimdhënës (për titujt profesor asistent, i asocuar, dhe i rregullt), në aspektin e plotësimit të kriterit të publikimeve shkencore.

Në total janë shqyrtuar dhe emëruar 131 kandidatë në tituj respektiv. Në 130 raste, vendimi i Senatit dhe rekomandimi i ORCA-s ka qenë në përputhje (99%). Në rastin e 131, Senati ka vendosur për avancimin e një kandidati, për të cilin ORCA ka vlerësuar që nuk i plotëson kriteret sa i përket publikimit shkencor, për shkak të një punimi në të cilin ai nuk figuronte si autor korrespondent në momentin e verifikimit. Korrespondenca është ndryshuar më vonë.

Kandidatët e rekomanduar për avancim	Kandidatët e rekomanduar për riemërim	Përputhja e rekomandimeve të ORCA-s dhe Senatit të UP-së
117	14	99%
Total: 131		

Në një rast tjetër, kandidati e plotëson kriterin e publikimit shkencor, por ka konflikt interesi me Universitetin e Prishtinës si institucion. ORCA ka rekomanduar që ky kandidat mos të emërohet jashtëligjshëm në këtë universitet, por Senati ka vendosur që të emërohet.

REZULTATET SIPAS TITUJVE AKADEMIKË

PROFESOR ASISTENT

68 kandidatë janë rekomanduar pozitivisht për titullin profesor asistent nga komisionet vlerësuese, këshillet e fakulteteve, Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, dhe Senati i Universitetit të Prishtinës. Të gjithë këta kandidatë e plotësojnë kriterin e publikimeve shkencore sipas legjislacionit në fuqi.

4 kandidatë të rekomanduar pozitivisht për titullin profesor i asocuar nga komisionet vlerësuese dhe këshillet e fakulteteve, janë propozuar për riemërim në titullin profesor asistent nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit dhe Senati i Universitetit të Prishtinës.

Kandidatët për profesor asistent të vlerësuar pozitivisht	Kandidatët e rekomanduar për riemërim në profesor asistent	Përputhja e rekomandimeve të ORCA-s dhe Senatit të UP-së
68	4	100%
Total: 72		

PROFESOR I ASOCUAR

31 kandidatë janë rekomanduar pozitivisht për titullin profesor i asocuar nga komisionet vlerësuese, këshillet e fakulteteve, Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, dhe Senati i Universitetit të Prishtinës. Të gjithë këta kandidatë e plotësojnë kriterin e publikimeve shkencore sipas legjislacionit në fuqi.

10 kandidatë të rekomanduar pozitivisht për titullin profesor i rregullt nga komisionet vlerësuese dhe këshillet e fakulteteve, janë propozuar për riemërim në titullin profesor i asocuar nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit dhe Senati i Universitetit të Prishtinës.

Kandidatët për profesor të asocuar të vlerësuar pozitivisht	Kandidatët e rekomanduar për riemërim në profesor të asocuar	Përputhja e rekomandimeve të ORCA-s dhe Senatit të UP-së
31	10	100%
Total: 41		

PROFESOR I RREGULLT

18 kandidatë janë rekomanduar pozitivisht për titullin profesor i rregullt nga komisionet vlerësuese, këshillet e fakulteteve, Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, dhe Senati i Universitetit të Prishtinës. 17 kandidatë e plotësojnë kriterin e publikimeve shkencore sipas legjislacionit në fuqi. Një kandidat i propozuar për profesor të rregullt nuk e plotëson këtë kriter, sipas verifikimit të ORCA-s.

Kandidatët për profesor të rregullt të vlerësuar pozitivisht	Përputhja e rekomandimeve të ORCA-s dhe Senatit të UP-së
18	94%

REZULTATET SIPAS FAKULTETEVE

Në konkursin nr. 804 të datës 14 maj 2021, janë shpallur pozita në 14 fakultetet e Universitetit të Prishtinës për mësimdhënës dhe asistentë. ORCA ka shqyrtuar vetëm pozitat për mësimdhënës (për titujt profesor asistent, i asocuar, dhe i rregullt), në aspektin e plotësimit të kriterit të publikimeve shkencore. Në vijim janë rezultatet sipas fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.

FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në Fakultetin e Arkitekturës janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **dy** (2) kandidatë për **profesor asistent**, dhe **një** (1) për **profesor të asocuar**. Të njëjtit janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të tre kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **dy** (2) kandidatë për **profesor asistent**. Të njëjtit janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të dy kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI JURIDIK

Në Fakultetin Juridik janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **tetë (8)** kandidatë për **profesor asistent**, dhe **tre (3)** për **profesor të asocuar.** Të gjithë, përveç një kandidati për profesor të asocuar janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Një nga kandidatët për profesor të asocuar nuk i plotësonte kriteret sa i përket publikimeve shkencore, dhe është rekomanduar për riemërim në profesor asistent. Kandidatët e tjerë i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I ARTEVE

Nga ORCA janë shqyrtuar vetëm kandidatët për lëndë teorike, për të cilët vlejnë të njëjtat kritere sa i përket publikimeve shkencore. Një kandidat për profesor të rregullt për lëndë teorike është rekomanduar pozitivisht nga komisioni vlerësues. Kandidati nuk i plotëson kriteret sa i përket numrit

të publikimeve shkencore, dhe është rekomanduar nga Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati të riemërohet në titullin profesor i asocuar.

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **një (1)** kandidat për **profesor të rregullt,** dhe **pesë (5)** kandidatë për **profesor asistent.** Të gjithë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në Fakultetin e Filologjisë janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **pesëmbëdhjetë (15)** kandidatë për **profesor asistent, dy (2)** kandidatë për **profesor të asocuar** dhe **dy (2)** kandidatë për **profesor të rregullt.** Të gjithë, përveç një kandidati për profesor të rregullt, janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Kandidati që nuk i plotësonte kriteret për profesor të rregullt është propozuar për riemërim në profesor të asocuar. Të gjithë kandidatët, përveç kandidatit për profesor të rregullt, i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI EKONOMIK

Në Fakultetin Ekonomik janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **katër (4)** kandidatë për **profesor të rregullt, dy (2)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **trembëdhjetë (13)** kandidatë për **profesor asistent.** Të gjithë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët, përveç një kandidati për profesor të rregullt, i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

Në këtë fakultet shënohet e vetmja mospërputhje mes rekomandimeve të ORCA-s dhe vendimeve të Senatit. Arsyeja për këtë mospërputhje është përcaktimi i kritereve etike shtesë për ndryshime të dyshimta në korrespondencë të punimit.

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO – NATYRORE

Në Fakultetin e Shkencave Matematiko – Natyrore janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **katër (4)** kandidatë për **profesor të rregullt, gjashtë (6)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **katër (4)** kandidatë për **profesor asistent.** Një kandidat për profesor të asocuar është rekomanduar nga Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati për riemërim në profesor asistent për shkak

të mungesës së punimeve. Një kandidat për profesor të rregullt është rekomanduar nga Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati për riemërim në profesor të asocuar për shkak të një çështje etike.

Kandidatët e tjerë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati.

Të gjithë kandidatët, përveç kandidatit të riemëruar në profesor asistent, i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Kandidati i riemëruar në profesor të asocuar, si dhe një kandidat i propozuar për profesor asistent, i plotësojnë kriteret e publikimit shkencor, por kanë probleme të theksuara me aspekte të etikës, dhe konfliktit të interesit.

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **katër (4)** kandidatë për **profesor të rregullt, një (1)** kandidat për **profesor të asocuar,** dhe **dy (2)** kandidatë për **profesor asistent.** Kandidatët për profesor të rregullt dhe kandidati për profesor të asocuar janë rikthyer për shqyrtim në Këshill të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit, për shkak të mungesës së punimeve shkencore, mentorimeve në PhD, pjesëmarrjes në konferenca, në projekte, mungesë të teksteve mësimore ose monografisë.

Dy kandidatët për profesor asistent janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Këta dy kandidatë plotësojnë plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

Kandidatët e tjerë, për profesor të rregullt dhe të asocuar, janë dërguar nga ORCA në Këshillin e Etikës për plagjiaturë në punimet e paraqitura në buletine.

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **tre (3)** kandidatë për **profesor të rregullt, dy (2)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **tre (3)** kandidatë për **profesor asistent.** Një kandidat për profesor të rregullt është rekomanduar nga Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati për riemërim në profesor të asocuar.

Kandidatët e tjerë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati.

Të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **katër** (**4**) kandidatë për **profesor asistent**. Të njëjtit janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI FILOZOFIK

Në Fakultetin Filozofik janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **dy (2)** kandidatë për **profesor të rregullt, dy (2)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **dy (2)** kandidatë për **profesor asistent.** Të gjithë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I EDUKIMIT

Në Fakultetin e Edukimit janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **dy (2)** kandidatë për **profesor të rregullt, dhjetë (10)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **gjashtë (6)** kandidatë për **profesor asistent.**

Dy kandidatët për profesor të rregullt janë rikthyer në shqyrtim në Këshill të Fakultetit të Edukimit, dhe nuk janë shqyrtuar më tutje. Rrjedhimisht të dy kandidatët janë riemëruar në profesor të asocuar.

Një kandidat për profesor të asocuar është rekomanduar nga Trupa Këshillëdhënëse dhe Senati për riemërim në profesor asistent për shkak të mungesës së punimeve.

Kandidatët e tjerë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët, përtej tre kandidatët e lartpërmendur, i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

FAKULTETI I MJEKËSISË

Në Fakultetin e Mjekësisë janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese **dy (2)** kandidatë për **profesor të rregullt, gjashtë (6)** kandidatë për **profesor të asocuar,** dhe **dy (2)** kandidatë për **profesor asistent.** Të gjithë janë rekomanduar pozitivisht edhe nga Trupa Këshillëdhënëse e Rektorit, si dhe nga Senati. Të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret për titujt respektiv sa i përket numrit të publikimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

REZULTATET SIPAS GJINISË

Nga 131 kandidatë për tituj profesorialë në këtë konkurs, të rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese dhe të shqyrtuar në Senat, 56 janë gra (43%).

Kandidatët e emëruar sipas gjinisë dhe titujve akademikë											
Profesor asistent				Profesor i asocuar				Profesor i rregullt			
Gra		Burra		Gra		Burra		Gra		Burra	
Prop ozuar	Riem ëruar	Prop ozuar	Riem ëruar	Prop ozuar	Riem ëruar	Prop ozuar	Riem ëruar	Prop ozuar	Riem ëruar	Prop ozuar	Riem ëruar
36	0	32	4	12	2	19	8	6	0	12	0
36		36		14		27		6		12	
50%		50%		34%		66%		33%		67%	

Pavarësisht (gati) barazisë gjinore në numrin e përgjithshëm të kandidatëve të shqyrtuar dhe propozuar për emërime në këtë konkurs, vërehet që gratë në përgjithësi ende nuk kanë arritur barazi në tituj më të lartë akademikë si ai i asocuar ose i rregullt, ku dominojnë burrat ende.

Gratë në përgjithësi plotësojnë kriteret shumë më shumë se burrat. Ato rekomandohen për avancim akademik në shumicën e rasteve vetëm kur plotësojnë kriteret (vetëm 2 gra kandidate janë rekomanduar për riemërim për shkak të mungesës së punimeve), ndërsa te burrat ka më shumë raste të riemërimit për shkak të mosplotësimit të kritereve (12 kandidatë).

Po ashtu, i vetmi rast ku është rekomanduar avancim akademik pavarësisht mosplotësimit të kritereve, është një kandidat burrë.

METODOLOGJIA

Baza ligjore

1. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës[1]
2. Statuti i Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht nenet 175, 176, 177[2]
3. Udhëzimi administrativ 01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[3]
4. Udhëzimi administrativ për plotësimin dhe precizimin – (aneksi –i- masht) 7/2018 e udhëzimit administrativ 01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.[4]
5. Rregullorja nr. 191 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"[5]

ORCA ka shqyrtuar publikimet e të gjithë kandidatëve të vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese për pozitën mësimdhënës në konkursin nr. 804, të datës 14 maj 2021. Shqyrtimi i publikimeve shkencore është bazuar në kriteret e vendosura në ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet administrative 01/2018 dhe 07/2018, Statutin e Universitetit të Prishtinës, si dhe rregulloren nr. 191 për avancime akademike në UP.

Objekti i shqyrtimit

Në total, janë shqyrtuar 116 kandidatë të rekomanduar për emërim, riemërim, ose avancim në tituj akademikë profesor asistent, i asocuar, ose i rregullt. Të dhënat për publikimin shkencor të këtyre kandidatëve janë marrë nga buletinet e publikuara nga Universiteti i Prishtinës.

Pjesë e hulumtimit kanë qenë të 14 fakultetet e Universitetit të Prishtinës, duke përfshirë për herë të parë edhe Fakultetin e Arteve, specifikisht kandidatët për lëndë teorike, për të cilët vlejnë të njëjtat rregulla për publikime shkencore. Profesorët për lëndë artistike nuk janë shqyrtuar.

---

[1] Ligji për Arsimin E Lartë, 2011, Linku: Https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdocumentdetail.Aspx?Actid=2761
[2] Statuti I Universitetit Të Prishtinës "Hasan Prishtina", 2012, Linku: Https://Dokumente.Uni-Pr.Edu/
[3] Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, Linku: Http://Masht.Rks-Gov.Net/Uploads/2018/01/Ua-Nr-01-2018-Parimet-E-Njohjes-Se-Platoformave-Dhe-Revistave-Nderkombetare-Me-Recension.Pdf
[4] Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: Http://Masht.Rks-Gov.Net/Uploads/2018/05/Ua-7-2018-Per-Plotesimin-Dhe-Precizimin-E-Ua-Parimet-E-Njohjes-Per-Revistat-Nderkombetare_1.Pdf
[5] Rregullorja nr. 191 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", 2021, linku: Https://Dokumente.Uni-Pr.Edu/

Për realizimin e këtij hulumtimi, ORCA ka filluar shqyrtimin e buletineve nga qershori deri në dhjetor 2021, periudhë ku janë botuar buletinet periodikisht.

PLOTËSIMI I KRITEREVE PËR AVANCIM

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, sipas legjislacionit në fuqi, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas legjislacionit në fuqi, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018, ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70.

Sipas rregullores së UP-së, punimet e publikuara pas datës 1 qershor 2020 duhet të jenë në platformën Scopus ose Web of Science në mënyrë që të vlejnë për avancime. Punimet e botuara pas kësaj date në platforma tjera nuk janë numëruar nga ORCA.

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore vendore dhe të vendeve fqinje, bazuar në rregulloren nr. 191 janë barasvlerësuar me koeficient 0, përveç në rastet kur këto revista janë të indeksuara në Web of Science ose Scopus.

Publikimet në revista të listuara si të dyshimta apo që botuesin e kanë të listuar si të dyshimtë janë barasvlerësuar me koeficient 0 dhe janë numëruar për nevoja të këtij hulumtimi. Njëjtë është vepruar edhe me revistat të cilat janë përjashtuar nga Senati i UP-së.

Sipas rregullores së UP-së, autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar; nëse ka më shumë se një autor korrespondent të specifikuar në punim, konsiderohet vetëm autori i parë i identifikuar si i tillë. Në rastet kur nuk specifikohet autori korrespondent, dhe janë vetëm dy autorë, konsiderohet autori i dytë si autor korrespondent. Korrespondenca në punim është vlerësuar siç është identifikuar dhe paraqitur në momentin e verifikimit të punimit nga ORCA. Rastet kur korrespondenca është ndryshuar pas momentit të verifikimit, nuk janë pranuar.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.









